



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 472/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelet e paraqitura nga Hajdar Beqa, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHEN** të pabazuara apelet: Anr.472/2019, Anr.473/2019, Anr.474/2019, Anr.475/2019, Anr.476/2019, Anr.477/2019 dhe Anr.478/2019, të gjitha të datës 08.11.2019, të paraqitura nga Hajdar Beqa, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2019, ka pranuar apelet: Anr.472/2019, Anr.473/2019, Anr.474/2019, Anr.475/2019, Anr.476/2019, Anr.477/2019 dhe Anr.478/2019, nga Hajdar Beqa, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në të cilat pretendon se me bërjen e rinumërimit të votave nga ana e KQZ-së, është bërë ndryshim i rezultatit në dëm të kandidatit në fjalë, ashtu që në Qendrën e Votimit në Rahovec Nr.1610A/0R, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 16 vota në dëm të të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Gjakovë Nr.0231C/01R, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 23 vota në dëm të të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Prishtinë Nr.1934E/02R, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 17 vota në dëm të të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Gllogoc Nr.0307E/02D, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 16 vota në dëm të të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Gjakovë Nr.0225C/05D, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 14 vota në dëm të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Mitrovicën Veriore Nr.1106B/01D, diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 42 vota në dëm të të njëjtit; në Qendrën e Votimit në Gjakovë Nr.0225C/04R,

diferenca e votave të numërimit dhe pas rinumërimit për kandidatin Hajdar Beqa është 4 vota në dëm të njëjtit, ku si dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij, paraqitësi, apeleve të lartëcekura u ka bashkangjitur kopje të FRK-ve nga vendvotimet.

Në përgjigje në apel, KQZ-ja, lidhur me pretendimet e apeluesit se me rastin e rinumërimit në vendvotimet e cekura si në apel nga KQZ-ja është bërë ndryshim i rezultatit në dëm të apeluesit, ka sqaruar anën procedurale të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve dhe ka theksuar se asnjë Formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti do t'i nënshtrohet Auditimit në QNR.

PZAP-i, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartëcekura dhe i trajton si një apel të evidentuar me Anr 472/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve në aspektin subjektiv dhe atë përmbajtjesor, si dhe për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelet e lartëcekura, vlerësoi se:

#### **Apelet janë të pabazuara**

Paneli pas shikimit në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se pretendimet e paraqitësit të apeleve të lartëcekura janë të pabazuara për faktin se nga vet deklaratimet e apeluesit vërtetohet fakti se me rihapjen e kutive të votimeve, gjegjësisht me rinumërimin, është konstatuar saktë diferenca e votave që kandidati në fjalë i ka pasur në vendvotimet përkatëse. Rezultatet preliminare nuk janë rezultate të ankimeshme dhe gjatë procesit të rinumërimit nëse ka mospërputhje mund të përmirësohen, ashtu siç ka vepruar QNR-ja, në këtë rast me rastin e rinumërimit.

Ndërsa provat e paraqitura në apelet në fjalë, sipas vlerësimit të PZAP-it, nuk paraqesin referencë ligjore në mbështetje të pretendimeve në apel e as bazë të vlefshme ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për paraqitësin e apeleve.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.472/2019 më datë 09.11.2019

**Kryesues i Panelit**

**Rrustem Thaqi**



Prishtinë / Pristina

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.***